

U D H Ë Z I M
Nr. 3, datë 14.7.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 18.3.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT NR.112, DATË 18.3.1999, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË
11.5.1993, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE TË
LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994, “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin nr.1, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Kreu I i udhëzimit ndryshohet si vijon:

“Për zbatimin e pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.112, datë 18.3.1999, të Këshillit të Ministrave, kontributet minimale mujore, sipas degëve të sigurimit, për punëmarrësit dhe për efekt të sigurimit vullnetar të personave të tjerë janë:

Pas datës 1 korrik

- Dega e sigurimit të sëmundjeve	117 lekë
- Dega e sigurimit të barrës së lindjes	218 lekë
- Dega e sigurimit të pensioneve	2 464 lekë
- Dega e sigurimit të aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale	39 lekë
- Dega e sigurimit të papunësisë	466 lekë
- Dega e sigurimit shëndetësor	264 lekë
Shuma:	3 568 lekë

2. Në kreun II, shtohen këto paragrafe:

“Në bazë të Kodit të Punës, punëdhënësi duhet të ketë lidhur kontratën individuale me punëmarrësit e tij, ndërsa në zbatim të vendimit nr.594, datë 22.12.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij”, duhet të mbajë regjistrin e evidentimit të punës dhe dokumente të tjera, që vërtetojnë pagën e punëmarrësve, për çdo muaj. Në bazë të këtyre dokumenteve punëdhënësi harton listëpagesat mujore dhe i paraqet ato, sipas formatit tip, në organet e sigurimeve shoqërore.

Për ndërprerjet e punës apo për ditët e munguara në punë, do të veprohet:

- Mungesat në punë për arsye shëndetësore do të justifikohen me raportin mjekësor, të paraqitur.

- Ndërprerjet në punë do të justifikohen nga akti i mbajtur nga punëdhënësi mbi shkaqet e ndërprerjes në punë.

- Për rastet e fillimit të punës apo të largimit të punonjësve gjatë muajit, saktësimi i tyre do të mbështetet në regjistrin që mban punëdhënësi si dhe në deklarinimin e tij pranë organeve të sigurimeve shoqërore.

Në këto kushte për ditët e munguara do të bëhen llogaritjet përkatëse për secilin punëmarrës dhe konkretisht, paga mujore, brenda kufijve (7 773-23 319 lekë) do të pjesëtohet me ditët e punës së muajit të caktuar në kontratë. Në këtë mënyrë del paga ditore, e cila duke u shumëzuar me 45.9 për qind, jep kuotën ditore për efekt të kontributeve të sigurimit shoqëror dhe atij shëndetësor. Ditët e punuara duke shumëzuar me këtë kuotë ditore japin shumën e kontributeve mujore të këtij punëmarrësi”.

3. Në kreun III shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“ Të vetëpunësuarit, të cilëve me vendim gjykatë u është njohur e drejta për të punësuar persona, të cilët nuk janë pjesëtarë të familjes së tij apo ortakë me të, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrësi dhe të zbatojnë kriteret e kreut II, të këtij udhëzimi.

4. Efektet e këtij udhëzimi fillojnë më datën 1 korrik 2000.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta